



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 44 Prot.

Tiranë, më datë 21.01.2022

VENDIM
Nr. 16, datë 21.01.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.01.2022:

VENDOSI:

1. Të miratojë rishikimin e “Projektit arkitektonik Mozaiku i Tiranës”, monument kulture i kategorisë së I-rë, me aplikues Anisa Bejko, zhvillues “Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Vendim KKTKM Nr. 148, datë 19.03.2021;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, Ligji Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, punimet e restaurimit të zbatohen dhe mbikëqyren në mbështetje të nenit 72, pika 1 dhe 2;
3. Procesi i prishjes së godinës ekzistuese, të realizohet nën mbikëqyrjen e specialistëve arkeologë të DRTK Tiranë, e më pas të realizohet gërmimi arkeologjik i të gjithë gjurmës së objektit nga DSHA dhe DRTK Tiranë, me qëllim evidentimin dhe dokumentimin e potencialit arkeologjik të mundshëm;
4. Të hartohet projekti i restaurimit dhe konservimit të strukturave të vilës romake dhe ambientit me mozaik, nga DRTK Tiranë në bashkëpunim me IKTK;
5. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkruara elektronikisht të dokumentacionit tekniko-ligjor pranë Sekretarisë Teknike në IKTK;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;

8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

